

E DIEL  
25 Nëntor  
2012



e-mail: milosao2005@yahoo.com

# 100 Vjet Shqipëria Jonë

Dossier/Specialë kushtuar Festës së Pavarësisë

Ismet Toto, Gjergj Frashëri, Teuta Hoxha, Ledia Dushku, Pirro Stefa, Betim Muço,  
Pjetër Logoreci



RYVARRIMI  
**R**

*Kjo është historia e thjeshtë, por tepër e jashtëzakonshme e një qytetari shqiptar, i cili ndodhet prej vitesh në Vjenë. Me një iniciativën e vet private dhe me ndihmën e Dr. Bernhardt Stillfried, bëri të mundur që më tetor të vitit 2010, të rizbulonte eshtrat e Imzot Nikollë Kaçorrit në varrezat qendrore të Vjenës...dhe t'i sillte në Durrës...*

NGA PJETER LOGORECI

**N**ë Austri e sidomos në Vjenë e në Graz, kanë studiue e punue shumë shqiptarë nga të gjitha trevat e vendit. Nga studimet, librat, artikujt e ndryshëm asht e njohtun vepra e aktiviteti i tyre, në të gjitha lamët e shkencës, letërsisë, artit, gjuhësisë në periudha të ndryshme. Për shqiptarët që jetojnë sot në Austri, asht temë e shpeshtë bisedash, njohja e aktivitetit të ktyne figurave apo zbulimi i ndonji dokumenti apo episodi nga jeta e tyre. Disa vjet ma parë më rastisi të kapë fillin e një bisede mbi Imzot Nikolle Kaçorrin, për të cilin dija shumë pak (çka kishim mësuë në shkollën e programet e regjimit komunist), por në bisedë me klerikun e misionit katolik në Vjenë, Don Izak Doda mu zgjue dëshira për me marre veshit ma shumë rreth kësaj figure që vuni themelet e shtetit të parë shqiptar. Don Izaku kishte fillue me ndjekë gjurmët e jetës së Kaçorrit në Vjenë, e po kërkonte me ndihmën e administratës së varrezave qendrore të Vjenës, të dhëna për gjetjen e varrit të tij. Tue mos pasë kontakte të shpeshta, nuk pata dijeni se deri ku vazhduen kërkimet e tija për Kaçorrin. Ma vonë ndigjova që një nga pjestarët e familjes Kaçorri, kishte kërkuë ndihmën e ambasadës shqiptare në Vjenë, të cilët e kishin vënë në kontakt me varrezat qendrore të Vjenës, prej ku ishte marrë e saktë adresa e varrezës së patriotit. Kërkesës së familjarit për nxjerrjen e eshtnave, administrata e varrezave i ishte përgjegjë negativisht, tuj gjetë si shkak ndodhjen e një peme pranë varrit, e cila me hapjen e gropës në thellësinë 3 metra do të damtohej ose rrëzohej.

Ma pas gjithshka u la në heshitje. Kurioziteti për të vizitue varrin e Imzot Kaçorrit më bani që të vihem në kontakt me një punonjëse të zyrës së varrimeve me origjinë shqiptare e cila edhe pse shumë skeptike, më tregoi rrugën që unë duhet të ndjekë për exhumimin dhe transferimin e eshtnave të patriotit në Durrës. Në këtë kohë isha bashkëpunëtor i një instituti në Vjenë që ishte i angazhuem me projektet e Austrisë në Europën Lindore, ku futje edhe Shqipëria. Drejtuesi i saj Dr. Bernhardt Stillfried, një burrë shumë i njohtun në qarqet e larta politike e diplomatike, ishte njohës i mirë i vendit tonë dhe mbështetës i shumë projekteve austriake në të gjithë Shqipërinë. Mund të përmend këtu bibliotekën e Institutit të Shkodrës, Shkollën teknike Austriake "Peter Mahringer" etj. Duke pasë mbështetjen e tij, unë konceptova dhe drejtova dy projekte të randësisë së ishte ai: Kërkime Arkivore mbi Ndre Mjedën (në



Varri i Dom Nikollë Kaçorrit në Vjenë



# "Kalvari" i mbramë për patriotin Kaçorri

ndihmë të studiuesit Mentor Quku) e Projektin NIKOLLE KAÇORRI (exhumimin dhe kthimin e eshtrave në atdhe) të herojt tonë kombëtar. Kujtoj që sapo ja propozova Shefit tim kte projekt, ai u tregue i gatshëm të ndihmojë, por më parë (ishte procedura e çdo projekti) duhej që të informohej për koston e projektit në fjalë. Ai më dha Ok-in e vazhdimit të projektit i cili i kushtoj institutit rreth 4500 Euro. Për dijeninë e lexuesit, vendosa që për ta ba sa me masive e të randë-

Azienda ime e takimeve filloj me nëpunësin e lartë të shtetit austriak RgR (Regierungsrat) Zoti Leopold Tichacek, i cili ishte drejtori i përgjithshëm i administratës së Varrezave të Vjenës. Mbas e informova mbi projektin,

ai ngarkoj nëpunësin e administratës qendrore Z. Gabriele Grüll që të ndjekë procedurat e exhumimit mbasi të qartësohej vendosja e pemës afër varrit si dhe vendodhja e dy personave të tjerë të bashkëvarrosur në kte

varr. U aktivizue ekspertiza e pemës nga inxhinieri Franz Tolloschek (nëse ajo damtohej me hapjen e varrit), nga i cili u konfirmue lejimi i hapjes së varrit, por pa prerjen e rrënjëve të pemës present. Mbas përgjigjes pozitive të ekspertizës, më 20 tetor 2010, i drejtova administratës së varrezave në Eien, kërkesen zyrtare për nxjerrjen e eshtnave të Nikollë Kaçorrit.

Në një takim me nëpunësin kryesor të varrimeve, Zoti Kotzik, mbasi i bëra atij të njohun firmën garant që i priste eshtrat në Rinas, u firmos kontrata për exhumimin dhe riadhesimin e eshtrave të NIKOLLE KAÇORRIT në atdhe (Durrës), ku shteti austriak merre përsipër përkundrejt pagesës, nxjerrjen e eshtrave, plotësimin e dokumentacionit (pasaportës e certifikatave të ndryshme). Lejen në ambasaden shqiptare në Vjenë, magazinimin e sargut deri në ditën e fluturimit e biletën e avionit për sargun. Pagesa ishte e lartë mbasi duhej të pagueja edhe sargun për eshtra të dy personave të tjerë të cilët ishin po në të njëjtin varr me Kaçorrin, por në thellësinë 2m (burrë e grue).

Dita e hapjes së varrit u cak-tue 1 shkurti. Ishte një ditë shumë e ftohtë ku temperatura arrinte në minus 10°. U gjenda në varreza rreth ores 07 së mbashku me dy pjestarë të misionit katolik (Pren Kolen e Kastriot Deden). Gjatë gërmimit në thellësinë 1,5 e 2m, dolën eshtrat e bashkëshortve austriakë, Ferdinandit e Antonias, të cilët ishin të varrosur (i dyti) në distancë një metër me Kaçorrin, eshtnat e te cilit u gjetën rreth 3m thellë (siç parashikohej nga teknikët e varrezave). Nuk mund të përshkruaj përjetimin e momentit kur u gjeten ato, por emocionet me pushtuen



sishme exhumimin e eshtrave të Nikolle Kaçorri, ti afrojo bashkëpunim dhe informacion, bashkësisë katolike shqiptare në Vjenë ku edhe unë baj pjesë. Mora pëlqimin e institutit për kte bashkëveprim dhe bashkë me përfaqësuesin e misionit Pren Kolen formuluem kërkesat për mbështetje. Dëshiroj të theksoj që kleriku Pren Kola, atë kohë zyrtar në misioni (misioni ka ndrrue deri tashti 4 klerikë), vepronte sipas vendimeve të këshillit të misionit për çdo aktivitet e jo si person privat.



Eshtrat e Dom Nikollë Kaçorrit të sapo zbuluara

krejt qenien time, kur pashe qe ishin te mbeshjtjella ne flamurin kombetar shqiptar, i cili si edhe eshtrat ishte i rrujtun mire.

Skepticizmi qe tregonin punonjesit e varrezave qe mbas 94 vjetesh te kishim nje rezultat te mire, ishte i madh, prandaj gjetja e eshtnave ishte nji ngjarje pozitive per te gjithe grupin. Eshtnat u moren po ate dite nga punonjesit e varremeve per tu depozitue ne frigoriferi deri ne dite e fluturimit per ne Rinas.

Me daten 6 shkurt ne bashkesine katolike ne Vjene, u organizue nji meshe solemne per nder te Imzot Kacorrit, ku moren pjesë bashkatdhetar si dhe shumë te ftuar nga miqte austriake e perfaqesues diplomatike. Diten e 9 shkurtit 2011, sargu me eshtnat e Imzot Kacorrit mbas 94 vjetesh u ulen ne token shqiptare i shoqeruem nga Pjeter Logoreci (si perfaqesues i Institutit Osterreichkooperation dhe Kulturvereinigungs) e kleriku Pren Kola (si perfaqesues i bashkise katolike shqiptare ne Vjene).

Dëshiroj të falenderoj për mbeshjetjen e interesimin personal, ambasadorin shqiptar ne Vjene, Zotni Villi Minarolli me të cilin pata kontakte intensive informative per mbarevajtjen e projektit si dhe punonjesin e ambasades Egin Ceka, i cili u angazhue me formulimin e perkthimin (sipas porosise së Zotit Minarolli) te dokumentit për pranimin e eshtnave ne territorin shqiptar. U deshën shumë përpjekje per te marr miratimin dhe nje fond shtese nga Instituti, per blerjen e biletës per klerikun Pren Kola i cili si perfaqesuesi i misionit deshironte te udhetonte se bashku me mue per te shoqne sargun ne drejtim te Rinasit. Sipas biletës ne duhej qe te arrinin ne Tirane para sargut, mbasi une kisha me vehte autorizimin per marrjen ne dorezim te sargut ne Rinas, por arriem ma vone, e sargu me eshtnat e Kacorrit ishte tashma ne duert e familjareve e te qytetarve durrsake, te cilit kishin ardhë per ta nderue firmetarin e pamvarsise. Vargu i gjate i makinave dhe autobusave fillonte me ne krye makinën e Imzot Damian Kurtit (ku isha edhe une) i cili me shume pasion e dashuni ka qene prezent me ndihmen e tij kudo ku bahej fjale per Nikolle Kacorrin. Flamuret shqiptare valviteshin e pankarta me fotografite e Nikolle Kacorrit ishin ngjitur kudo ne dritaret e makinave. Ne kte atmosfere festive e patriotike nuk ndihej pothuajse aspak mungesa e nji ceromonie per patriotin nga ana e shtetit si dhe mungesa e daljes te ndonji personaliteti te Arqipeshkvisë te Tiranës. Kur arriem ne Durres, kisha e Shen Lucise ishte e mbushur plot me qytetare durrsake, te cilet edhe pergjate rruges kryesore na pershendetshin me respekt. Imzot Damian Kurti i kishte marre masat qe me ane te posterave te medhej te lajmeronte ngjarjen e vecante e te shume pritur per te gjithë. Nuk mund te pershkruhet gezimi i bashkeqytetarve, te cilet prenin me dashuri sargun e Nikolle Kacorrit. Une isha pamase i gezuar mbasi arrita te kurorzoj me sukses nje veprim qi kishte 94 vjet qe priste doren e dikujte. Fundin e projektit e kurorzoza me procesverbalin e marrjes ne dorezim te sargut me eshtnat e Imzot Kacorrit nga Imzot Damian Kurti, dokument i cili se bashku me nje informacion perfundimtare, duhej per mbylljen e dosjes.

Se fundit deshiroj te shkruaj dy rreshta ne shenje respekti e falenderimit per ate qe bani te mundun realizimin e ketij projekti. Dr. Bernhard Stillfried i cili nuk jeton me. Burri qe perkrahu ndricimin e figurave me te medha te kombit shqiptar si Nikolle Kacorri e Ndre Mjeda, ai qe nuk tha kurr jo, kur kerkohej vendimi i tij per programet ne ndihme te Shqipnise.

Pushofsh ne paqe miku jonë! Shpresoj se emri i tij do të mbesë në memorijen e shqiptarëve e do të ketë mirënjohjen e qytetit të Durrësit e të gjithë Shqipnisë.

PROZA  
**P**

*Një emocion i pastër i autorit, kushtuar Kosovës. Me një figuracion të thjeshtë, por me një poezi të ndjerë, ky është kontributi i tij i madh poetik për Kosovën*



## Erëra të reja fryjnë mbi Kosovë

*Kushtuar Sagitës në 100-vjetorin e Pavarësisë*

NGA BETIM MUÇO

### Malet e Sharrit

Malet e Sharrit  
Si çakshirë Kosovo  
Me dëborën e parë të vitit  
Mbi shpinë  
Edhe pse vendlindjen e kam larg  
Që këtej  
Zogitë e vendlindjes  
Këtu cicërijnë.

### Gryka e Rugovës

Humbet një cast  
E prapë feks  
Në grykë të Rugovës  
Qielli  
Dhe hapësira valëvitet  
Si këngë e lashtë  
Majekrahi  
Ndërsa mendoj  
Sa ngajmë njerëzit  
Me vendet që ata i lindën.

### Prishtinë

Të njoha von  
Prishtinë  
Në muzg të jetës sime  
Dhe pse në mendje të kam patur  
Që fëmijë  
Ja pra tek je  
E vjetër dhe e re  
Nënë burrash e grash  
Të fisme e krenare  
Atje ku historia  
Të dukshme i la vrugat  
Si akullnajat e herëshme  
Shpateve të maleve  
Por prapë je e bukur  
E hareshme  
Si një ëndërr  
Që dhe pse mbetet ëndërr  
Nuk e humb magjinë  
E të qenit jotja  
Prishtinë  
Nuk dua gidë për ty  
Siç s'dua gidë  
Për udhët e mia të shpirtit.

Në Mitrovicë

Në Mitrovicën e veriut  
Ca djem të ngazëllyer  
Puthën gishtërinjtë  
Dhe vunë pëlëmbët  
Mbi xhamin e makinës sime  
Me targa të Tiranës  
Thellë qënies  
Diçka m'u drodh  
Dhe gjaku im u bë flamur  
Përshtolli horizontet.

Fushë-Kosovë

Si një pëlëmbë të madhe  
Kërkoj vijat e fatit  
Në Fushë-Kosovë  
Erërat shpleksen të lira  
Nga gjithë anët  
E Ballkanit  
Dhe troku i lashtë  
I kuajve të luftës  
Ende gjallon e ndihet  
Herëpashere  
Në sfond të ditëve të njerëzve  
Po t'ja thosha këtë  
Fshatarit që shtet specat e bukur  
Të Kosovës  
Ndanë rrugës  
Do thoshte padyshim  
Që jam i çmendur.

Në Boletin

Kam bredhur botën  
Anekënd  
Muzë pafund kam parë  
Madhështorë  
Po askërkund  
S'jam ndërë kaq pa gojë  
Sa te kjo shtëpi e thjeshtë  
Në Boletin.

Dëborë kishte zbardhur kodrat  
Gjer në Trepçë  
Dhe strehët pikonin  
Mbi supet e burrit  
Që me mundim po rrekej  
Të hapte braven e ndryshkur të derës.

Dikur ajo u hap

Dhe Isë Boletini më tha: Bujrum  
Shtathedhur e pakëz mënjanoar  
Që nga fotografia bërë  
Prej kolonelit Tomson.

Shtëpia është e re  
E bërë vonë  
Mbi gurët e djegur të së vjetrës  
Këtu veç shkëmbi i murrme  
I pagojë  
Flet e tregon për ata që kanë veshë.

E komplikuar jeta sot  
O bacë  
E vetëkomplikuar gjer në dhëmbje  
Dhe s'është e lehtë  
T'i japësh udhë trimërisë  
E mendjes  
Siç bërë ti në ditët e qemotit.

Newborn

Erëra të reja fryjnë mbi Kosovë  
Në Sharr  
Një bari më dha adresën e e-mailit  
Dhe një prift serb në Deçan  
Ma rrëfeu shqip historinë e manastirit  
Në Renesansë të Prishtinës  
Kënduam "A kanë ujë ato burime"  
Dhe një film nga Zelanda e Re  
Fitoi Dokufestin e Prizrenit.

Erëra të reja fryjnë mbi Kosovë  
Flamuri i lashtë i kuq  
Mbetet në zemër  
Flamuri i ri i kaltër  
Hapet në qiell  
Dielli bën rrugëtimin e zakonshëm  
Lindje-perëndim  
Pa u ndikuar nga lajmet e ditës  
Dhe makinat e KFOR që venë e vijnë  
Rrugëve  
Tek ngrihet  
Shtetit më të ri të botës  
I merren këmbët  
Por nuk ka vend që s'bëhet  
Kur duan njerëzit ta bëjnë.

Erëra të reja fryjnë mbi Kosovë  
Dhe u japin udhë ditëve të reja.